



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1592, datë 18.03.2011

Për

“Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Vodafone Albania sh.a., ndaj Vendimit nr. 1487 datë 10.01.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, për mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 18.03.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Vodafone Albania sh.a., ndaj Vendimit nr. 1487 datë 10.01.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, për mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)

3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (***Rregullorja e Brendshme***), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918
4. Rregullore për Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Vodafone Albania nr. Ref CEO/017/E.Xh datë 11.02.2011 në lidhje me aktin administrativ, Vendimi nr.1487, datë 10.01.2011 të AKEP, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendim nr. 1450, datë 12.11.2010 të KD të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”, (***Ankimi Administrativ***);
2. Vendim Nr.1487, datë 10.01.2011 të AKEP për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendim nr. 1450, datë 12.11.2010 të KD të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”, (***Vendimi***);
3. Projektvendim i KD të AKEP për “Shqyrtimin e Ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a., ndaj Vendimit nr. 1487 datë 10.01.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, për mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. (***Eagle***) dhe Vodafone Albania sh.a. (***Vodafone***)”, (***Projektvendimi***);
4. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (***Relacioni***);
si dhe,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Faktet, pretendimet dhe kërkesat e ankimuesit:
 1. Vodafone me shkresën nr. CEO/017/E.XH., datë 11.02.2011 (AKEP: nr. 3500/5 prot, datë 11.02.2011), ka depozituar në AKEP, ankimin administrativ kundër Vendimit nr. 1487, datë 10.01.2011 të KD të AKEP, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin nr. 1450, datë 12.11.2010, të KD të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”.
 2. Në shkresën ankimuese Vodafone pretendon se marrja e Vendimit nr.1487, datë 10.01.2011, është në kundërshtim me Kodin e Procedurave Administrative (K.Pr.A), pasi:

- a) Në kuadër të procedurës së nisur nga AKEP-i me kërkesën e Eagle-s, vendosur me Vendimin Nr. 1450, datë 12. 11. 2010 për zgjidhjen e mosmarrëveshjes pas dështimit të bisedimeve për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit midis tij dhe Vodafone-s, Vodafone, në shkresën përcjellëse dërguar AKEP-it me nr. LDG/0393/AC, datë 14.12.2010, për depozitimin e “*Marrëveshjes së Inerkoneksionit (MI)*”, pamvarsisht se midis palëve në mosmarrëveshje u arrit lidhja e MI-së, ka kërkuar një përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur për procedimin administrativ për çështjen e tarifave mes Eagle dhe Vodafone për periudhën Prill-Korrik 2010.
- b) Fakti që është nënshkruar marrëveshja e interkoneksionit mes Eagle dhe Vodafone, nuk përbën heqje dorë nga ana e Vodafone për këtë çështje.
3. Për pasojë të sa më sipër, Vodafone, konsideron se AKEP ka marrë VKD nr. 1487, datë 10.01.2011, në kundërshtim me përcaktimet e K.Pr.A., duke i mohuar palës së interesuar Vodafone, që të marrë një vendim përfundimtar nga AKEP, në lidhje me këtë çështje, në kundërshtim të hapur me vullnetin e shprehur nga Vodafone me shkresën Nr. LGD/0393/AC të datës 14.12.2010.
4. Vodafone, në përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen ka mbajtur qëndrimin në përputhje me aktet rregullatore, si më poshtë:
- Midis Vodafone-s dhe Eagle-s ka qenë në fuqi marrëveshja e interkoneksionit nga data 1.04.2009, me afat 12 muaj, me të drejtë shtyrje 3 muaj, me tarifë terminimi të thirrjeve në rrjetin e Eagle-s në masën 13.32 lekë/min;
- AKEP, me VKD nr. 1212, datë 31.03.2010, “*Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese*” ka vendosur tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve në rrjetin e Eagle në masën 12.20 lekë/min, duke përcaktuar se ky Vendim hyn në fuqi menjëherë;
- Eagle e ka ankimuar Vendim nr. 1212 datë 31.03.2010, dhe AKEP me anë të Vendimin nr. 1346, datë 23.07.2010, e ka pranuar pjesërisht ankimit administrativ të Eagle Mobile dhe vendosi tarifë maksimale të terminimit të thirrjeve në rrjetin e Eagle në masën 12.92 lekë/min, duke përcaktuar se ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
- Vodafone e ka ankimuar Vendimin nr. 1346, datë 23.07.2010, dhe AKEP me Vendimin nr. 1404, datë 23.09.2010, “*Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone në lidhje me aktin administrativ VKD nr. 1346, datë 23.07.2010, të AKEP*” ka vendosur lënien në fuqi të VKD nr. 1346, datë 23.07.2010, dhe rrëzimin e ankimit të Vodafone;
5. ***Për këto arsye, duke vlerësuar se:***
- Në bazë të nenit 138, të K.Pr.A, ankimi administrativ i Eagle kundër VKD nr. 1212, ka pezulluar zbatimin e këtij vendimi për një periudhë 30 ditore, nga data 28.04.2010-28.05.2010. Kjo do të thotë se nga data 01.04.2010-27.05.2010, ka mbetur në fuqi tarifa: 13.32 lekë/min, sipas MI të datës 01.04.2009;
- Në bazë të nenit 138, të K.Pr.A, pas 30 ditësh ka përfunduar afati pezullues i ankimit administrativ, ndaj dhe VKD nr. 1212, datë 31.03.2010, ka hyrë automatikisht në fuqi. Kjo do të thotë se nga data 28.05.2010 - 23.07.2010, do të aplikohet tarifa 12.20 lekë/min, sipas VKD nr. 1212;

Në zbatim të VKD nr. 1404, datë 23.09.2010, AKEP ka vendosur që prej datës 24.07.2010 e në vijim do të aplikohet tarifa në masën 12.92 lekë/min.;

Moszbatimi i tarifave të lartpërmendura sipas afateve kohore përkatëse shkakton një situatë shumë serioze nga ana financiare për Vodafone-n;

Në zbatim të nenit 44, 101, 124, 112, 137, 138, 139, 140 të K.Pr.A, nenit 60 të Ligjit nr. 9918, si dhe përcaktimet e rregullores nr. 18 datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”;

Vodafone, bazuar në nenin 124, të K.Pr.A i kërkon AKEP-it:

- a) Revokimin e Vendimit nr. 1487, datë 10.01.2011, dhe marrjen e një vendimi përfundimtar për mosmarrëveshjen mes palëve, që kërkon zbatimin e tarifave të interkoneksionit për terminimin në rrjetin e Eagle Mobile sh.a., si më poshtë:

Në masën prej 13.32 lekë/min për periudhën kohore 01.04.2010-27.05.2010;

Në masën prej 12.20 lekë/min për periudhën kohore 28.05.2010-23.07.2010;

Në masën prej 12.92 lekë/min për periudhën kohore 24.07.2010 e në vazhdim;

- b) Lëshimin e një Urdhëri (neni 60, i ligjit nr. 9918) për ndryshimin e Marrëveshjes së Interkoneksionit midis Vodafone Albania sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a., ku të pasqyrohen tarifat sipas vlerave të lartpërmendura.

II. Qëndrimi i AKEP-it lidhur me pretendimet dhe kërkesat e ankimuesit, është:

1. Vendimi Nr. 1487, datë 10. 01. 2010, i KD të AKEP-it për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendim nr. 1450, datë 12.11.2010 të KD të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”, është një akt administrativ i nxjerrë në zbatim të nenit 50, 60 dhe 120 të ligjit nr. 9918 dhe akteve normative rregullatore të nxjerra nga AKEP-i, me marrjen e kërkesës nga sipërmarrësi Eagle për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tij dhe sipërmarrësit Vodafone lidhur me marrëveshjen e interkoneksionit, duke zbatuar KprA, për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj (pika 3 e nenit 120 të ligjit nr. 9918).

Për marrëdhëniet e akses/interkoneksionit dhe marrëveshjen e interkoneksionit ligji nr. 9918 përmban një sërë dispozitash të karakterit procedural dhe thelbësor, mbi bazën e të cilave palët e interesuara dhe AKEP-i si organ rregullator kompetent i fushës, veprojnë për vendosjen e interkoneksionit sipas marrëveshjes së negociuar mbi bazën e ofertës referencë të interkoneksionit. Në rastet kur një MI, sipas neneve 46 dhe 47 të ligjit nr. 9918, nuk arrihet nga palët për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, atëherë në bazë të nenit 60 të këtij ligji, AKEP-i shqyrton pretendimet e palëve, sipas nenit 50 të këtij ligji urdhëron lidhjen e MI-së.

Në rastin konkret, megjithëse AKEP-i kishte nisur procedimin administrativ sipas përcaktimeve të nenit 50, 60 dhe 120 të ligjit nr. 9918 për shqyrtimin e pretendimeve dhe urdhërimin e lidhjes së MI-së, duke qenë se palët Eagle dhe Vodafone përpara nxjerrjes së urdhërit nga AKEP arritën lidhjen e MI-së midis tyre, çka nënkupton tërheqjen e pretendimeve që bëhesheshin pengesë për moslidhjen e MI-së, atëherë KD

i AKEP i ndodhur në kushtet e rënies së shkakut ligjor për urdhërimin e lidhjes së MI-së (pasi nuk ekzistonte më shkakut për të cilin ankimesi, sipërmarrësi Eagle kishte paraqitur ankimin në AKEP sipas nenit 50 dhe 120 të ligjit nr. 9918), arsyetoi marrjen e Vendimit nr. 1487, datë 10. 01. 2011 për mbylljen e procedimit të nisur me Vendimin nr. 1450, datë 12. 11. 2010.

Kërkesa e Vodafonit nëpërmjet shkresës përcjellëse për depozitimin e MI-së (shkresë nr. LDG/0393/AC, datë 14.12.2010), për marrjen e një përgjigje sa më të shpejtë për procedimin administrativ të nisur me VKD nr. 1450, datë 12. 11. 2010 nuk përbën shkak ligjor për trajtimin e kësaj mosmarrëveshje sipas procedurës së nisur nga AKEP sipas nenit 50, 60 dhe 120 të ligjit nr. 9918 për shqyrtimin e pretendimeve që janë bërë pengesë nga palët për lidhjen e MI-së, pamvarsisht se kjo procedurë fillon në përputhje me KPrA. Në rastin e shqyrtimit të pretendimeve për moslidhjen e MI-ve nga palët, nuk është procedura (procedimi në përputhje me KPrA) ajo që përcakton qëllimin dhe shkakun ligjor për fillimin e procedimit nga AKEP-i, por është ekzistenca e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9918 ajo që legjitimon fillimin dhe zbatimin e procedimit në përputhje me KPrA për arritjen e lidhjes së MI nëpërmjet nxjerrjes së urdhërit nga AKEP. Kur shkakut ligjor, pra moslidhja e MI-së, nuk ekziston më përpara se AKEP-i të nxjerri urdhërin sepse palët arrijnë lidhjen e MI-së, atëherë AKEP-i nuk mund të vijojë më tej me nxjerrjen e Urdhërit administrativ. MI e lidhur midis palëve nuk ka efekte prapavepruese çka detyrimisht do të kërkonte nevojën e trajtimit të tyre nga ana e AKEP-it në kuadër të procedimit të nisur.

Nëse Vodafone pretendonte ekzistencën e mosmarrëveshjes me Eagle për nivelin e tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin e Eagle-s për periudhën midis dy MI-ve (në referencë kjo dhe me vendimet e AKEP-it për këtë qëllim) dhe kërkonte zgjidhjen e saj nga AKEP-i, kjo nga pikpamja formale administrative kërkon zbatimin në përputhje me KPrA e një procedure të veçuar nga ajo që zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me objekt moslidhjen e MI-së. Për këtë arsye Vodafone, si palë kërkuese duhej që në përputhje me nenin 120 të ligjit nr. 9918 dhe aktet normative administrative të nxjerra nga AKEP-i për këtë qëllim, të paraqiste kërkesën për zgjidhjen e saj nga AKEP-i duke saktësuar objektin e mosmarrëveshjes.

2. Megjithë sa më sipër, me qëllim bërjen të ditur për palët të qëndrimit të AKEP-it lidhur me zbatimin e tarifave të interkoneksionit për terminimin në rrjetin e Eagle Mobile, sqarohet se:
 - a) AKEP në pikën 2 të Vendimin nr. 1404, datë 23.09.2010 *“Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a, në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr.1346, date 23.07.2010 te AKEP, për “Shqyrtimin e ankimit administrativ te Eagle Mobile sh.a. për ndryshim të Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, datë 31.03.2010 te AKEP, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, ka vendosur momentin e hyrjes në fuqi të përcaktimit të pikës 1/c të Vendimit nr. 1346 datë 23.07.2010 si më poshtë vijon:*

Tarifa maksimale e terminimit të thirrjeve në rrjetin Eagle Mobile, e përcaktuar në Vendimin nr.1346, datë 23.07.2010, në nivelin 12.92 lek/minutë dhe 0.39 lek/për thirrje, është në fuqi nga data 24.07.2010.

- b) Për periudhën 01.04.2010 - 23.7.2010, tarifa e terminimit në rrjetin Eagle Mobile që duhet të aplikohet është tarifa e aplikuar deri më 31.03.2010, pra në nivelin 13.32 lek/minutë.
 - c) Palët Eagle Mobile dhe Vodafone Albania do të duhet të zbatojnë tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetin e Eagle, sipas vlerave dhe afateve të mësipërme, të cilat AKEP ka vënë re se janë parashikuar tashmë edhe në Marrëveshjen e Interkoneksionit të nënshkruar midis tyre më datë në datë 13.12.2010 me kohëzgjatje 01.04.2010 deri më 31.03.2011;
3. Lidhur me kërkesën për lëshimin e një Urdhëri (neni 60 i ligjit nr. 9918) për ndryshimin e MI-së midis Vodafone –s dhe Eagle ku të pasqyrohen tarifat sipas vlerave dhe afateve të kërkuara në shkresën ankimore, kjo është një kërkesë e pabazuar pasi sipas nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP-it i lejohet të nxjerrë urdhër, për sa kohë palët dështojnë në arritjen e një marrëveshje aksesi dhe interkoneksioni.

AKEP, për sa më lart konsideron së palët Vodafone Albania sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a., meqëse kanë arritur të lidhin marrëveshje interkoneksioni midis tyre, gjykon se nuk jemi në kushtet për lëshimin e një urdhëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

- 1. Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 1487, datë 10. 01. 2010, i KD të AKEP-it për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendim nr. 1450, datë 12.11.2010 të KD të AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a” dhe rrëzimin e ankimit.
- 2. Lidhur me zbatimin e tarifave të interkoneksionit për terminimin në rrjetin e Eagle Mobile, të sqarojë se qëndrimi i AKEP-it është si më poshtë vijon:
 - a) Palët, për periudhën nga data 1.04.2010 deri më datë 23.07.2010, të zbatojnë tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve në rrjetin e Eagle Mobile sh.a. prej 13.32 lekë/min, sipas Marrëveshjes së Interkoneksionit të nënshkruar me datë 1.04.2009;
- 3. Të njoftojë Vodafone Albania sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a., për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al;

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**